

SiCRED ASSISTANCE NË ROLIN E NDËRMJETËSIT

Sicred Assistance, si subjekt i së drejtës shqiptare pas një eksperience disa vjeçare, mund të flasë publikisht për rolin e saj në çështjet e ndërmjetësimit për shërbime mjekësore. Megjithëse një çështje e ndjeshme për të gjithë ne, shëndeti, pacienti dhe shërbimet mjekësore, ishin në qendër të diskutimit tonë për herë të parë, në konferencën rajonale të mbajtur në Tiranë në 15-10-2019, si një bashkëprodhim me Istituto Auxologico Italiano, subjekt mjekësor privat me rezidencë aktiviteti në Milano Itali.

Kompleksiteti i çështjeve të ndërmjetësimit për shërbime cilësore shëndetësore në aspektin teknik, si dhe nevoja për shërbime cilësore shëndetësore nga pacientë, që kërkojnë shërbime të parashikuara mjekësore, duke analizuar hollësisht edhe efektin ekonomik të tyre, janë në fokus të këtij artikulli.

Në vazhden e trajtimit analitik dhe kritik të çështjeve, që prekin shëndetin, pacientin dhe projektojnë sugjerime në rritjen e cilësisë së shërbimeve mjekësore, dua të ndalem tek disa aspekte, të ndërmjetësimit, në rolin e tij primar.

NDËRMJETËSI DHE PACIENTI

Kur flasim për ndërmjetësim në shërbime mjekësore, nuk mund të anashkalojmë faktin që ndërmjetësi në rolin e vet natyral qëndron, ndërmjet pacientit dhe subjektit, ku merret shërbimi mjekësor.

Ndërmjetësi, në ndihmë dhe sipas porosisë, informon pacientin mbi alternativat për marrjen e shërbimit shëndetësor, në kushte të pazakonta dhe në transparencë të plotë me protokollin mjekësor e kostot për shërbimin mjekësor.

Ndërmjetësi, është tërësisht i pavarur nga enti shëndetësor, ku do të merret shërbimi shëndetësor, por në të njëjtën kohë është edhe i kushtëzuar nga aprovimet dhe detyrat që sipas kontratës i ka dhënë pacienti kërkuar, për shërbim mjekësor pranë një institucioni mjekësor privat.

Megjithëse, termat e përdorur në këtë industri shërbimesh sot në botë janë të ngjashëm, "ndërmjetës" apo "broker" ato nuk mund të përdoren në mënyrë të gabuar dhe në deformim të kontekstit të kontratës së porosisë.

Në mënyrë të thjeshtë dhe shteruese, ndërmjetësi/Sicred Assistance, paguhet nga pacienti për shërbimin e ndërmjetësimit në përzgjedhjen e subjektit shëndetësor për shërbimin më adekuat shëndetësor.

Ndërmjetësi, nuk ka asnjë lloj lidhje varësie apo funksionale me subjektin mjekësor, ku do të marrë shërbimin pacienti kërkuar.

Nga njëra anë e medaljes të gjitha këto tipare, e identifikojnë autoritetin e ndërmjetësimit, si një institucion të pavarur, tërësisht autonom e me detyra të qarta, që burojnë nga marrëdhënia kontraktuale e ndërtuar me pacientin, që kërkon shërbim cilësor mjekësor.

Nga ana tjetër autoriteti i ndërmjetësimit, imponon bashkëpunim transparent me subjektin privat mjekësor, pranë të cilit pacienti do të marrë shërbimin mjekësor, mbështetur në nevojat për shërbim të parashikuar, sipas protokolleve dhe praktikave mjekësore më të mira e përcaktimeve kontraktuale.

Këto angazhime në të dy kahet e pozicionojnë ndërmjetësin, në qendër të trekëndëshit të komunikimit, porosisë sipas nevojave, gjitha edhe të transmetimit të protokollit dhe këshillave rehabilituese në vijimësi.

Pozicioni, si ndërmjetës në këtë trekëndësh është sa i dobishëm, po aq edhe efikas në drejtim të përmirësimit të disa aspekteve të shërbimit shëndetësor, edukimit dhe transparencës.

NDËRMJETËSIMI DHE SUBJEKTI SHËNDETËSOR PRIVAT

Një tipar dallues në shërbimin e ndërmjetësimit për përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm shëndetësor, është edhe marrëdhënia e mirë rregulluar mes ndërmjetësimit dhe institucionit privat mjekësor, ku do të referohet pacienti.

Në të gjitha rastet kjo marrëdhënie është sintetizuar në një kontratë që balancon të drejtat dhe detyrimet, ndërmjet ndërmjetësimit që do të referojë pacientin dhe subjektin privat shëndetësor.

E lexuar drejt, kjo marrëdhënie mes këtyre palëve, krijon një mjedis të përshtatshëm, për të pasur një platformë ekonomike avantazhuese, sa i takon çështjeve të qasjes së pacientit, në kërkim të një subjekti, që ofron shërbim cilësor mjekësor.

Të tillë vlerësim avantazhues kostosh, pacienti mund ta perceptojë vetëm, pasi të ketë të qarta kostot e shërbimit mjekësor në subjektin privat shëndetësor, si dhe avantazhet e qasjes së pacientit, nëpërmjet ndërmjetësimit.

Pagesa, që kryhet nga pacienti, i përqsuar në institucionin mjekësor, nëpërmjet kësaj rruge është më e ulët në vlerë nominale, se çdo pagesë tjetër për të njëjtin shërbim, që pacienti do të kryente, nëse do të afrohej personalisht dhe pa ndihmën e ndërmjetësimit pranë të njëjtit subjekt privat mjekësor.

Gjithaq protokollin mjekësor, ekipi i mjekësor, procedurat e trajtimit mjekësor, rehabilitimit sipas rastit për një sëmundje të caktuar përfshirë edhe akomodimin e pacientit dhe familjarëve shoqëruar, janë së bashku çështje që paracaktohen



dhe parashikohen në kontratën që lidhet me pacientin porosisë.

Çështje të tilla, janë të domosdoshme e si të tilla në mënyrë transparente, kanë identifikuar të drejtat dhe detyrimet, mes palëve, duke kufizuar mundësinë për dykuptimësi, avantazhuar vlerësimin dhe përzgjedhjen eficiente në kohë, gjykimin profesional në kushte të pazakonta, për përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm shëndetësor.

IMPAKTI I NDËRMJETËSIMIT

ASPEKTI RREGULLATOR - Megjithëse ligji është vijërojtësi i praktikave jo-korrekte mjekësore, mund të themi me siguri që ndihmesë në përmirësimin e shërbimit mjekësor, si dhe në rritjen cilësore të tij, në mjedisin e sotëm janë edhe shoqëritë e ndërmjetësimit.

Me eksperiencën e përftuar mund të pohojmë qartazi, se shërbimi i shoqërive ndërmjetëse, që ndihmojnë sipas kërkesave pacientin, në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor, ndikojnë drejtpërdrejt në imponimin për zbatim të saktë, të protokolleve mjekësore dhe në mjekimin e kujdesshëm dhe profesional.

Transmetimi i informacionit mjekësor nga mjeku apo institucioni referues, nëpërmjet ndërmjetësimit, tek subjekti mjekësor pritës, nxit korrektesën në zbatimin e protokollit mjekësor, gjitha edhe mjekimin e kujdesshëm dhe profesional.

TRANSPARENCA NDAJ PUBLIKUT - Ndërmjetësimi në shërbime mjekësore, nxit transparencën ndaj publikut në disa drejtime.

EDUKIMI I PUBLIKUT PËR SHËRBIM CILËSOR - Praktika ka treguar se procesi i ndërmjetësimit në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor, rrit kërkesën e pacientit për shërbim cilësor mjekësor. Nëpërmjet rrugës së ndërmjetësimit, në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor, rritet ekzigjenca për trajtim mjekësor profesional te pacientit.

VLERËSIMI PUBLIK BAZUAR NË MERITA - Ndërmjetësimi në përzgjedhjen e institucionit mjekësor si metodë alternative, nxit konkurrencën mes ekipit mjekësor, për të pasur suksese në trajtimin shkencor-mjekësor të pacientëve me patologji të caktuara. Publikimi i rasteve të trajtuara suksesshëm nga ekipi mjekësor, nxit shkëmbimin e eksperiencave shkencore inovative dhe pozitive në trajtimin e patologjive të caktuara.

PRAKTIKAT DEFEKTIVE - Është fakt që gjykatat e kanë shumë të vështirë që të gjykojnë, çështjet e neglizhencës së mjekut apo mjekimit e pakujdesshme bazuar vetëm në sa parashikohet në parimet e legjislacionit.

Është pothuaj e pamundur që vlerësimi për të shkuar tek e vërteta objektive, të vlerësohet nga gjykata bazuar në vetëm sa thotë ligji, për neglizhencë të mjekimit, mjekim të pakujdesshëm për patologji të caktuara, apo praktika korruptive, pa u vlerësuar në tërësi procesi i qasjes së pacientit tek mjeku përkatës dhe sjellja respektive tyre.



Ndërmjetësi për shërbim mjekësor, si një hallkë e cila qas pacientin me dhënësin e shërbimit mjekësor, sipas protokollit mjekësor, ndikon drejtpërdrejtë në informimin transparent të pacientit si klient me veprimet që do të kryej mjeku apo ekipi i mjekëve.

Kjo transparencë, ndihmon në gjykimin e çështjeve që prezantohen, sipas rastit në gjykatë për të pasur një qëndrim të balancuar në drejt peshimin e masës së dëmit të shkaktuar prej neglizhencës, apo mjekimit të parregullt dhe përgjegjësi që rrjedhin prej tij.

INFORMIMI PËR ÇMIMIN E SHËRBIMIT - Ndërmjetësi e ndërmjetësimit në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor, imponojnë përmirësimin e protokolleve mjekësore në vijimësi, në nivel horizontal dhe vertikal, ato plotësojnë e ndihmojnë regjistrimin e përditësimin e informacionit mjekësor.

REFORMIMI I SHËRBIMIT SHËNDETËSOR - Praktikant e ndërmjetësimit në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor, imponojnë përmirësimin e protokolleve mjekësore në vijimësi, në nivel horizontal dhe vertikal, ato plotësojnë e ndihmojnë regjistrimin e përditësimin e informacionit mjekësor.

Një sistem ndërmjetësimit në përzgjedhjen e shërbimeve shëndetësore të paracaktuara, shëndosh kërkesën e publikut për shërbim cilësor, nxit kërkesën për transparencë dhe vlerësimin kritik, e gjitha nxit konkurrencën për cilësi dhe kualitet në shërbime shëndetësore.

Përfundimisht, një sistem ndërmjetësimit në përzgjedhjen e shërbimeve shëndetësore të paracaktuara, mund të shërbejë shumë mirë për të përftuar informacion, bazuar mbi statistika për vlerësimin e pacientit për shërbimin shëndetësor publik dhe privat. Nga këndvështrimi i pacientit kuptohen nevojat për ndërhyrje dhe përmirësim, si dhe mund të identifikohen objektivist përgjegjësitë mes aktorëve dhe faktorëve si dhe ato institucionale me synim instalimin e një regjimi me pacientë të edukuar, praktika transparente e cilësore nga një ekip i kualifikuar mjekësh, për një standard më të mirë jetese të popullatës.

Vjosa Bodo

Administrator, Sicred Assistance shpk

